



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës
ëëë.uni-gjilan.net tel: 0280390112

RAPORT PËRMBLEDHËS PËR VLERËSIM TË STUDIMEVE NË UNIVERSITETIN 'KADRI ZEKA' NGA STUDENTËT ALUMNI

Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi

Fitore Malaj-Abdyli

<u>Hyrje</u>	Error! Bookmark not defined.
<u>1. Metodologjia e hulumtimit</u>	4
<u>1.1. Qëllimi i hulumtimit</u>	4
<u>1.2. Metodatat e hulumtimit</u>	4
<u>2. Rezultatet e Hulumtimit</u>	5
<u>2.1. Informata për rrjedhën e hulumtimit</u>	5
<u>2.2. Analiza e pyetësorë</u>	
Error! Bookmark not defined.	
2.2.1. Komentim i të dhënave demografike.....	6
2.2.2. Qëndrimet e Mësimdhënësve të UKZ-së në raport me pohimet e shprehura në pyetësor	Error!
Bookmark not defined.	
<u>3. Përfundimet dhe rekomandimet</u>	10

Hyrje

Duke u bazuar në Rregulloren për e Sigurimin e Cilësisë, Këshilli Mbikëqyrës i Cilësisë dhe Vlerësimit ka vlerësuar që është e nevojshme të realizohet një hulumtim me studentët e diplomuar lidhur me të diplomuarit e UKZ, me qëllim që të bëjmë rishikimet e nevojshme për programet studimore. Vlerësimet nga studentët e diplomuar janë të rëndësishme për të vlerësuar përvojën e studentëve në UKZ dhe identifikimin e fushave për përmirësim, veçanërisht për studentët e gjeneratave të ardhshme.

Me qëllim të mirëmbajtjes së kontakteve dhe komunikimit me të diplomuarit e Universitetit “Kadri Zeka”, kemi hartuar një pyetësor, i cili do t’i ndihmojë Universitetit të përmirësojë programet e studimit.

1. Metodologjia e hulumtimit

1.1. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi ka të bëjë me identifikimin e mangësive gjatë realizimit të plan programeve mësimore të mësimdhënësve në UKZ,poashtu cilësinë e studimeve që ofrojnë programet studimore të Universitetit Kadri Zeka për studentët që studiojnë dhe diplomojnë në këtë universitet.

Nga ky hulumtim kemi arritur të nxjerrim vlera të cilat identifikojnë problematikat me të cilat ballafaqohen studentët pas diplomimit .

Rekomandimet e dala nga ky vlerësim do t'u shërbejnë Njësive Akadematike për të reflektuar lidhur me përmisimet në zhvillimin e programeve të tyre.

1.2. Metodatat e hulumtimit

Hulumtimi u realizua kryesisht përmes metodës kuantitative dhe instrumenteve që janë në funksion të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave.

Shpërndarja e pyetësorëve u bë përmes platforës googel forms. Pyetësorët u shpërndanë në formë elektronike tek 300 studentë të dilomuar të Universitetit Kadri Zeka, gjatë periudhës 30 nëntor – 5 dhjetor të vitit 2020.

2. Rezultatet e Hulumtimit

2.1. Informata për rrjedhën e hulumtimit

Duke u bazuar në Rregulloren për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësimit tek neni 5 ku përcaktohen instrumentet për vlerësim të brendshëm të cilësisë është paraparë që përveç vlerësimit tjera , të bëhet edhe vlerësimi me studentët e diplomuar, kështu që në bashkëpunim me Këshillin Mbikëqyrës të Cilësisë kemi hartuar pyetësozin sipas Shkallës së Likertit, ku për secilin konstatim të anketuarit janë shprehur, me 5=Shumë i kënaqur; 4= I kënaqur; 3=Mesatarisht të kënaqur; 2=Pak të kënaqur; dhe 1=Aspak të kënaqur .

Për të realizuar hulumtimin është angazhuar Koordinatorja për alumni e cila ka siguruar kontaktet dhe ka bërë shpërndarjen e pyetësorëve tek studentët e diplomuar të Universitetit “Kadri Zeka”, kurse kthimin mbrapa të pyetësorëve e ka pranuar Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi në adresë elektronike. Në Zyrën për cilësi janë kthyer 164 pyetësorë të plotësuar nga alumni.


Pas përpunimit të dhënave është përpiluar raporti, i cili do t'i dorëzohet Këshillit Mbikëqyrës të Cilësisë dhe Vlerësimit si dhe menaxhmentit të lartë të UKZ-së.

Për hartimin e Raportit të Vetëvlerësimit si dhe publikimin e rezultateve ka punuar kryesisht Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi

2.2. Analiza e të dhënave


2.2.1. Komentim i të dhënave demografike

Grafikoni 1. Gjinia e të diplomuarve




Grafikoni 1 paraqet pjesëmarrjen e studentëve të diplomuar në hulumtimin tonë sipas gjinisë. Siç shihet 53.3 % e të anketuarve janë meshkuj, ndërsa me një përqindje më të ulët shihet pjesëmarrja e femrave me 46.7%.

Grafikoni 2. Fakultetet ku kanë përfunduar studimet alumni



Në grafikoni 2 paraqiten të dhënat e të anketuarve sipas fakulteteve ku kanë diplomuar. Shihet se përfshirje më të lartë ka Fakulteti Ekonomik me rreth 51.6%, pastaj Fakulteti i Edukimit me 22.6% pastaj Fakulteti Juridik me 16.1% dhe të diplomuarit e Shkencave Kompjuterike me 9.7%.

Grafikoni 3. Studentët pas diplomimit



Duke u bazuar në grafikun 3 shohim se më shumë se gjysma e të diplomuarve janë punësuar, rreth 57.1%. Ndërsa 35.7% prej tyre ende nuk janë punësuar.

2.2.2. Qëndrimet e studentëve të diplomuar të UKZ-së në raport me pohimet e shprehura në pyetësor

Tabela 1 Rezultatet e pyetësorit për Alumni të shprehura me mesatare

Konstatimet		Mesatarja
1	Kam zhvilluar të menduarit kritik dhe analitik	3.66
2	Kam fituar njohuri specifike për vendin e punës	3.84
3	Kam zhvilluar aftësitë për zgjidhjen e problemeve	4.03
4	Kam zhvilluar aftësi për punë kërkimore dhe hulumtuese	3.31
5	Kam fituar njohuri për mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave	3.66
6	Kam zhvilluar aftësitë komunikuese në komunikimin verbal dhe me shkrim	3.84
7	Kam fituar njohuri në përdorimin e gjuhës angleze	3.88

8	Kam fituar njohuri në përdorimin e teknologjisë informative	3.53
9	Kam fituar shkathtësi për punë ekipore dhe nën presion të kohës	3.28
10	Sjellja etike dhe vlerat morale janë parime të studimeve në UKZ	3.81
	Mesatarja e përgjithshme	3.68

Tabela 1 shpreh qëndrimet e të diplomuarve të UKZ-së, lidhur me aftësimin e tyre në aspektin teorik e praktik si dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës mësimor.

Nga të anketuarit janë kërkuar përgjigje në pohimet e parashtruara sipas shkallës së Likertit (nga 1- 5). Në përgjigjet e dhëna shihet se nuk ka dallime esenciale në qëndrimet e tyre . Në konstatimin e parë se sa kanë zhvilluar të menduarit kritik dhe analitik gjatë studimeve në UKZ, të diplomuarit janë shprehur deri diku të kënaqur në një shkallë mesatare 3.66, kjo tregon që një pjesë mesatarisht e kënaqshme e të anketuarve mendojnë se studimet e tyre kanë zhvilluar mendimin kritik dhe analitik. Një vlerësim të njëjtë shohim edhe tek konstatimi që ka të bëjë me njohuritë për mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave. Të anketuarit kanë vlerësuar me shkallë mesatare 3.66. Një ngritje të shkallës së vlerësimit vërejmë tek pohimet 2,6, 7 dhe 10. Lidhur me njohuritë specifike për vendin e punës studentët shprehen të kënaqur duke vlerësuar me shkallë mesatare 3.84. Me shkallë të njëjtë vlerësimi (3.84), të anketuarit shprehin qëndrimin e tyre edhe në zhvillimin e aftësive komunikuese si në komunikimin verbal poashtu edhe me shkrim. Në konstatimin se sa kanë fituar njohuri në përdorimin e gjuhës angleze të anketuarit shprehen të kënaqur me një mesatare prej 3.88. Me një mesatare të përafërt studentët kanë vlerësuar konstatimin se sjellja etike dhe vlerat morale janë parime të studimeve në UKZ.(3.81.) Një zbehje të shkallës së vlerësimit shohim në pohimet 4 dhe 9. Lidhur me zhvillimin e aftësive për punë kërkimore dhe hulumtuese studentët e diplomuar shprehen më pak të kënaqur, me një mesatare 3.31. Gjithashtu një ulje edhe me te theksuar shohim tek konstatimi i zhvillimit të aftësive për punë kërkimore dhe hulumtuese. Studentët vlerësojnë me një shkallë mesatareje prej 3.23. Një ngritje në shkallë vlerësimi shohim tek pohimi 3 lidhur me zhvillimin e aftësitësive për studentët në zgjidhjen e problemeve (4.03)

3.Përfundimet dhe rekomandimet

Duke u bazuar në të dhënat e këtij hulumtimi si dhe analizën të rezultateve të dy pyetësorëve për për studentët e diplomuar në UKZ mund të konkludojmë se dallimet në qëndrime ndërmjet studentëve karshi njohurive të fituara në Univesitetin “Kadri Zeka” janë të përafërta.

Programet studimore të UKZ-së, të cilat ofrojnë studime për student shihen pozitivisht nga të diplomurit. Këtë e dëshmon mesatarja e përgjithme e rezultateve të përgjithshme që është mbi 3.68 që nënkupton se shumica e studentëve që dalin nga Universiteti Kadri Zeka ka një të ardhme, e që gjithsesi duhet avansuar në zhvillimin e kapaciteteve në sigurim të cilësisë edhe më të lartë të studimeve.

Qëndrimet e të diplomuarve të shprehura me mesatare ndaj aspektev të cilat paraqesin njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë teorike e praktike të cilat ofrohen në UKZ , vlerësohen kënaqshëm nga të amketuarit Përveç në konstatimin 9 ku shkalla e vlerësimit është më e ulët, 3.23. .

Rezultatet tregojnë se me një diferencë të dukshme më të lartë se sa studentët, janë shprehur profesorët. Ata shprehen entuziastë në përdorimin e teknologjisë në organizimin e mësimimit. Këtë e tregon edhe vlerësimi në shumicën e konstatimeve i cili është mbi 4, përveç në konstatimet se ligjëratave iu ka munguar interaksioni si dhe realizimi ushtrimeve ka hasur në vështërsi ku ata kanë një shkallë vlerësimi më të ulët (Pohimi 7-2,72, Pohimi 8-2,69).

Vlen të theksohet se në konstatimin e fundit se a duhet të praktikojnë mësimin online edhe më tutje, shprehet një dallim i theksuar në vlerësim ndërmjet mësimdhënësve dhe studentëve, kjo tregohet me mesatare të ulët, të shprehur me 2.95 tek studentët, si dhe 4,08 tek mësimdhënësit.

Nga rezultatet e dala nga ky hulumtim mund të konstatojmë se studentër e UKZ-së janë relativisht të kënaqur me programet studimore të cilat kanë ndjekur ata por gjithsesi ka vend për përmisime. Në kuadër të gjetjeve nga ky hulumtim, rekomandimet tona janë:

- Studentëve t’u jepet mundësia që sa më shumë të kenë praktikë gjatë studimeve të tyre.
- Të rritet bashkëpunimi i Zyrës për zhvillim në Karrierë me Alumni lidhur me mundësitë

e punësimit.

- Të forcohet mësimdhënia me studentin në qendër lidhur me nxitjen e zhvillimit të mendimit kritik dhe analitik tek studentët
- Mësimdhënia në UKZ të organizohet në grupe dhe punë ekipore
- Të zhvillohen lëndët e Teknologjisë Informative dhe gjuhët e huaja në të gjitha programet studimore në UKZ.
- Të punohet në rritjen e universitetit me fakultete të reja dhe programe tjera studimore krahas zhvillimeve të tregut të punës.

